



Pranuar / Dorezuar Punijena/Prodato Received/Delivery	05.05.2023	viti god Year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	SKAMSHCK 4/21/2023	Shtesa Prilog Appendix
		Sasia Kolicina Quantity
		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 540/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e dhe vendosje e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtare si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar artë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A. nr. 540/2023, të datës 20.03.2023, së ankuesit _____, nga Komuna e Podujevës, kundër organit të punësimit Qendra e Studenteve e Universitetit të Prishtinës në çështjen juridike " masë disiplinore", duke vepruar në Pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur më ankesën A.nr.540/2022 të datës 20.03.2023, të parashtruar nga ankuesi _____.
- II. Ankuesi udhëzohet ta dërgoj ankesën ne Komisionin e Ankesave për Shërbyes Publik në Qendrën e Studentëve në kuadër të MASHT.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ e datë 20.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshill është regjistruar nën shenjën 2799/2023 me datë 20.03.2023, kundër vendimit me numër protokolli 118, të datës 21.02.2023, të Komisionit Disiplinor të Qendrës së Studenteve të Universitetit të Prishtinës.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i provave të lëndës ka gjetur se ankuesi është i punësuar në Qendrën e Studenteve, dhe se i njëjti sipas akt emërimit me numër nr. 133 të datës 15.07.2022, është i emëruar dhe ushtron pozitën e punës " Udhëheqës i Sektorit për Kulturë, Sport dhe Rini".

Me dispozitat e Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht me nenin 2 është përcaktuar se; "...2.Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik, neni 4, ku thuhet se: Nëpunësi i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, ndërsa me nenin 74, paragrafin 1,2 dhe 3 po të këtij ligji është përcaktuar se "1. Zyrtari i shërbimit publik mund të ankohet te punëdhënësi kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës. Ankimi paraqitet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga njoftimi i vendimit. 3. Shqyrtimi i ankesave është në kompetencën e Komisionit të Ankesave.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenit 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, thekson se Nëpunësi i Shërbimit Publik fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të filloj kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetues së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, andaj pas konstatimit se ankuesi nuk ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent që të shqyrtoj ankesat lidhur me kontestet e marrëdhënies së punës të nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës, kështu që mbi këtë bazë, Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit

Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr. 540/2023 të datës 20.01.2023, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesi nuk ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa të Qendra e Studenteve të Universitetit të Prishtinës.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hynë në fuqi me nënshkrimin e Kryetarit të Kolegjit.

Këshillë juridike; Kundër vendimit të Këshillit pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA A.nr.540/2023

Rushit KAJTAZI


Procesmbajtës

Eshref SHABANI



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Komisionit për Ankesa të Qendrës së Studenteve të Universitetit të Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Qendrën e Studenteve të Universitetit të Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

